



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/03-23740/2018  
Kaçanik, 31.07.2018

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII ( Tetë )** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 31 Korrik 2018. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsyen, Hafize Sallahi.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës Ylber Bajra dhe 7 drejtoret e drejtorive komunale (Zahir Doda, Fatmir Luku, Festim Neziraj, Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Bahri Selimi dhe Diana Reka).

Nga zyrtarë komunal ishin: Fatlume Guri, Bajtulla Dalloshi dhe Kaltrina Luma.

Nga OSBE- a në mbledhje mori pjesë, Faruk Dërmaku.

Në mbledhje mori pjesë, Kijani Sallahu nga OJQ dhe dy qytetare të komunës.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti. Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPI..

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfise Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndetë të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, e konstatoj kuorumin emër për emër, ndërkëq në vazhdim e hapi mbledhjen e VIII (Tetë ) të Rregullt të Kuvendit të Komunës përvitin 2018, data 31 Korrik, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) përgjashtëmujorin e parë të vitit 2018;
3. Raporti gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershori 2018;
4. Propozim Vendimi për transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018;

5. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-10, tokë bujqësore e klasës së III-të, në Zonën Kadastrale Kaçanik i Vjetër në pronësi të Xheladin Krasniqi;
6. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës Bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-9, tokë Bujqësore-kullosë e klasës së III-të zona kadastrale Kaçanik i Vjetër në pronësi të Xhevahir Krasniqi;
7. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të parcelës kadastrale nr.0968-7, tokë bujqësore kullosë e klasës së III-të, zona kadastrale Kaçanik i Vjetër në pronësi të Abedin Krasniqi;
8. Raporti i përfomancës së komunave për vitin 2017: dhe
9. Kërkesa e sheftit të GP të LVV- Ekrem Kyçiku, për ndërtimin e një, Hyrje-Dalje (Kyçje – Ç’ Kyçje) në Autostradën “ Arbër Xhaferi” Segmenti: Kaçanik- Hani i Elezit dhe anasjelltas.

Rendi i propozuar i punës u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 25 votë Për, Kundër ishte, Shemsedin Luzha. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës,

#### **APROVOJ**

**Rendi i Punës në përbërje prej 9 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VII (Shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës:

Vërejtje në Procesverbal paraqiti Adnan Reka, të cilat vërejtje mbeti t'i sjellë me shkrim dhe të njëjtat do të inkorporohen në procesverbal.

Procesverbal i mbledhjes së 7 të Rregullt i Kuvendit të Komunës, me vërejtje u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 23 votë Për, Kundër ishte, Shemsedin Luzha dhe Afërdita Shehi. Abstenim nuk pati, ndërkaq I anëtar nuk ishte në sallë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, e;

#### **APROVOJ**

**Procesverbalin nga mbledhja e 7 (Shtatë ) e Rregullt e Kuvendit të Komunës të datës 17 Korrik 2018/ Lënda 01Nr. 060 / 03-22143 /2018.**

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit konstatoj me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

##### **z. Ekrem Kyçiku,**

1. Në emër të LVV kemi vërejte se materiali i mbledhjes nuk po na vjen me kohë, kështu për herrave të tjera. Kërkojmë që materiali i mbledhjes të na vjen me kohë, ashtu si ë përcaktojnë rregullat ligjore.

2. Komuna e jonë dihet se ka mungesë të parkingjeve. Unë e kam një Kërkesë në emër të qytetarëve të komunës, që përmes DAK të lironet për Parking përkohësisht oborri i shkollës fillore "Emin Duraku" në Kaçanik, deri sa të filloj mësimi.

**z. Adnan Reka,** Çfarë ka ndodhë me Vendimin e KK për formimin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale. A është i domosdoshëm formimi dhe funksionalizimi i atij Komisioni, apo mos ka qenë i prill data dhe keni bërë shaka?

**z. Ekrem Raka,**

1. Kam një pyetje nga qytetarët e lagjes në rrugën "Jehona Raka" se a do të bëhet instalimi i ndriçimit publik në këtë lagje.
2. Të pozicioni: Pyetjet dhe Kërkesat, a ka mundësi t'i shtohet edhe pasuesi "dhe Deklarime" ( Pyetje, Kërkesa dhe Deklarime).

**z. Selim Reka,** Kam një kërkesë të përsëritur qysm nga legjislatura e kaluar, që të bëhet një Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës dhe Bashkësisë Islame, për Rishikimin e Vendimit për lejimin e mjeteve buxhetore për çështjen e varrimeve të qytetarëve të Komunës së Kaçanikut.

**znj. Nazife Krasniqi,** Përroi që përshkohet nga rruga " Hasan Prishtina" kah Kafiteria "Tropikali", duhet të pastrohet, sepse mund të na sjell probleme gjatë të reshurave atmosferike, kërkesë kjo e ngritur edhe me herët.

**z. Sali Malsiu,** Unë e kam një Kërkesë në emër të banorëve të f. Dubravë, për problemet e vazhdueshme të kanalizimeve që i kanë banorët e asaj anc.

**z. Bekim Koxha,**

1. Me intereson të di për çështjen e Tregut të Gjelbër në lokacionin të, "Kalaja" të dhënë me qira, kush e ka dhënë tregun me qira dhe kush e ka marrë me qira tregun. Është mirë ta shohim Kontratën dhe a është, Shfuqizuar Vendimi paraprak i organeve të komunës lidhur me dhënien e tregut me qira.
2. Të Shtëpia e shumarëve, një pjesë e pronës është dhënë në shfrytëzim dikujt e cila është interes i komunës, ndërkaq aty një pjesë e asaj prone është në emër të, Parkut Nacional.
3. Në f. Koxhaj ka pasur probleme me ujin e pijes, e kemi pasur një Kërkesë për këtë çështje, ndërkaq nuk është marrë asnjë veprim në këtë drejtim nga ana e organeve të komunës.
4. Të çështja e tokave bujqësore, kemi kërkuar edhe në mbledhjet paraprake me u formuar një Komision për çështjen e degradimit të tyre, por kjo kërkesë nuk është realizuar.
5. Rruga në drejtim të "Fushës së Pajtimit" është në gjendje të mjerueshme dhe paraqet rrezikshmëri të lartë për qytetarët e f. Doganaj dhe qytetarët tjerë që kalojnë atypari. Unë kërkoj përgjigje me shkrim nga organi kompetent rrëth kësaj çështje, përsë nuk janë marrë veprime për sanimin e gjendjes së rrugës në fjalë.

**z. Shemdesin Luzha,** Me datë 28 Mars 2018, ka qenë një Kërkesë e Lagjes Luzha, për një projekt të rrugës. Më intereson të di çka është bërë me atë Kërkesë të lagjes në fjalë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Jemi duke i dëgjuar të gjitha pyetjet dhe kërkesat, deklarimet etj., duhet ta kemi parasysh faktin së ne nuk mund të procedojmë më çështjet të cilat nuk janë pjesë e punës së Kuvendit të Komunës. Meqë nuk ka kërkesa të tjera, atëherë konstatoj me kaluar në pikën e radhës, ndërkaq përgjigjet në Kërkesa do t'i merrni nga ekzekutivi i komunës. Në vazhdim kalojmë në pikën vijuese:

**2. Raporti i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi(KKSB) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Raporti ka ardhur në procedurëtë KK, sepse nuk kalon përmes procedurës së KPF. Kryetari i Komunës është edhe Kryesues i KKSB, megjithatë kryetari është prezent këtu për sqarime të nevojshme, nëse ka kush diçka në Raportin e KKSB, e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçku,** Nga Raporti i KKSB, shihet se ka mbajtur 3 mbledhje, dhe janë dhënë disa rekomandime, si çështja e aktiviteteve për me e ftuar kompaninë "Bektel Enka" dhe Ministrinë e Infrastrukturës për me dhënë shpjegime rreth aktiviteteve kundërligjore në punimet e autostradës. Unë mendoj se me këtë çështje duhet të merret. Prokuroria e jo KKSB. Edhe disa rekomandime të tjera të potencuar si në pikët: 4 dhe 5 nuk janë në kompetencia të këtij këshilli, pastaj çështja e kanalizimit në f. Biçec, nuk duhet të jetë temë e KKSB.

**z. Adnan Reka,** Ky Këshill është organi më i lartë i sigurisë publike në nivelin Komunal, ndërkaq nuk e di a është i vetëdijshëm për rolin e vet të cilin e ka. Si organi më i lartë në fushën e sigurisë publike, ky këshill nuk duhet të merret me: Çështjen e kompensimit të anëtarëve të KKSB-së. Sjelljen e zyrtarëve komunal me qytetarë dhe anasjelltas: Çështjen e përfaqësimit në KKSB. Dhe kulmi është. Dy puseta adekuate në hyrje të rrugës "Mejdi Dalloshi", thua ti që të gjitha gjërat tjera janë në rregull, dhe ata duhet të merren me dy puseta adekuate në një lagje. Unë ose e kam keqkuptoj këtë Këshill, ose Këshilli ja ka huq fare, e unë besoj që është kjo e dyta. Ky Këshill duhet të merret me çështjen të tjera, si p.sh. Ekstremizmin Fetar, cilat janë veprimet që ka ndërmarrë Komuna për parandalimin apo ndalimin e kësaj dukurie, dhe për rikthimin e imazhit të mirë Komunës. Kaosin në trafik, gjatë fluksit dhe pas fluksit të mërgimtarëve – cilët janë hapat konkret që ky Këshill ka paraparë, jo vetëm në qytet por edhe nëpër lagje? Sigurisht i dini rastet e djegies së shtëpive nga pamundësia e depërtimit të zjarrfikësve, nga parkingjet ilegale nëpër lagje dhe pamundësinë e depërtimit të kamionit të mbeturinave dhe si pasojë kemi edhe deponi ilegale të mbeturinave nëpër lagje.

Pusetat, janë shqetësuese, por nuk janë vetëm dy puseta adekuate në një lagje të caktuar, janë me dhjetëra apo qindra pusteta të dëmtuara, të munguara, bile edhe të zhdukura në shumë lagje në tërë territorin e Komunës tonë që duhet të kujdeset ky Këshill.

Siguria e nxënësve në trafik, nënkalimin hekurudhorë për të shkolla në "Dushkajë" pa të cilin rrezikohen mbi 1000 nxënës nga treni për çdo ditë, e që nuk ka mbetur asnjë këshilltarë i opozitës pa e kërkuar, nuk po bëhet asgjë: pastaj është ajo shtylla e famshme elektrike e betonit afër shkollës "Emin Duraku" që të lë përshtypjen se është lënë me qëllim për t'i frikësuar apo përvendetur nxënësit me përkuljen e saj, nuk ndërrohet.

Deponitë ilegale të mbeturinave, janë 22 të regjistruara zyrtarisht, e që ka shumë më tepër jo zyrtarisht, të cilat janë burim permanent i ndonjë epidemie dhe që po na e nxijnë imazhin për çdo ditë. Ndriçimi publik që është vetëm në zonën e parë dhe pjesërisht në zonën e dyte, e kur është terr, siguria dihet në çfarë niveli është, e shumë dukuri të tjera me të cilat do të duhej të merrej Këshilli më i lartë i sigurisë publike në Komunë.

Unë konsideroj se këto janë detyrat e këtij Këshilli, t'iu bëjë. Rekomandime institucioneve përkatëse që t' i hartojnë dhe t'i zbatojnë Planet e Veprimit, t'iu Rekomandoj institucionet Komunale të marrin fushata vetëdijesimi ose dhe parandaluese për këto dukuri, e jo të merret me çështjen e kompensimit të anëtarëve të KKSBB, apo dy kapakëve adekuat të pushtave të një lagje.

**z. Shpend Krusha,** Tema e ardhme e KKSBB duhet të jetë; Çështja e narkotikëve, temë kjo aktuale dhe shqetësuese për komunën tonë. Me qëllim të ngritisë së sigurisë në vend, komuna duhet të merr veprime të nevojshme për vendosjen e kamerave të sigurisë në shkolla dhe në hyrje-dalje edhe të fshatrave.

**z. Ekrem Raka,** Unë pajtohem me diskutimet e parafolësve lidhur me vërejtjet të cilat i potencuan për rolin e KKSBB. Ky këshill i sigurisë, është organ këshillëdhënës për çështjen e politikave të sigurisë, ndërkaq aktivitetet e këtij këshilli shihet se janë përqendruar kryesisht me çështje të sigurisë e jo me i dhënë këshilla Kryetarit të Komunës për çështjen e sigurisë. Shtrohet pyetja, si duhet bëhet kjo? Përgjigja mungon.

**z. Bekim Koxha,** Me ardhjen e mërgimtarëve tanë, është shtuar numri i qytetarëve dhe automjeteve në komunikacion, njëkohësisht edhe shtimi i rreziqeve. KKSBB kujtoj së është dashur të merret me këtë punë, sepse ka nga radhët e shtëpive të mërgimtarëve, si është rasti të 5 shtëpive në f. Koxhaj të cilat iu janë thyer. Tjetër; Pasiguria në rrugën e f. Doganaj, dhe nuk është marrë askush me këtë çështje, pastaj rrezikshmëria e nxënësve në shkollën e f. Koxhaj etj.

**Kryetari i Komunës,** U bënë shumë pyetje, u ngiten shumë shqetësimë për të cilat shqetësimë edhe ne jemi pjesë e tyre. Është e vërtetë se KKSBB është organ këshillëdhënës e jo vendimmarriës dhe unë jam kryesues i këtij këshilli. Edhe të KKSBB është një pikë e ndryshme e rendit të ditës dhe në atë pikë, është e drejtë e çdokujt të ngritë shqetësimet e qytetarëve dhe është parë e arsyeshme me u shqyrtaar shqetësimet e qytetarëve. Të aktivitetit të KKSBB, i gjithë aktiviteti i potencuar është në Planin e Punës së KKSBB dhe në mbledhjet vijuese të KKSBB do të janë objekt shqyrtimi. Të çështja e dëmtimeve të rrugëve nga kompania "Bektel Enka" janë të arsyeshme të gjitha vërejtjet të cilat i potencuat. Për vitin e ardhshëm, unë kam prezantuar në Debatin publik të organizuar me qytetarë dhe nëse mendoni se ndonjë projekt është i paarsyeshëm, urdhëroni e heqim. Ne mund të ulemi e të debatojmë me opozitën dhe ta heqim ndonjë projekt dhe të intervenojmë me ato mjete në sanimin e gjendjes së rrugëve, mirëpo nuk kam pasur ndonjë kërkesë për çështjet të cilat sot po i ngitni. Kështu mirë ka qenë kur iu kam ftuar Debatin publik me qytetarë, me qenë pjesë e këtyre debateve. Unë jam me bërë një Marrëveshje me "Bektel Enka" për gjendjen e rrugëve si kanë qenë, si janë tanë dhe në fund me i kthyer në gjendje të mëparshme. Unë kam pasur raste kur i kam urdhëruar inspektorët me bërë inspektim kompanisë "Bektel Enka", por kemi pasur. Kërkesë nga Ministria se nuk kemi të drejtë me i penguar. Ankesa kemi pasur, por asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje me shkrim, kështu unë në vija të tjera nuk kam pasur se çka me bërë më tepër rreth këtyre çështjeve.

**z. Bekim Koxha,** A ke mundësi kryetar me ia ndal punimet kompanisë "Bektel Enka" deri me rregullimin e rrugës të cilën e kanë dëmtuar, qoftë edhe me masa policore, me shfrytëzuar autoritetin tënd kryetar, ashtu që deri sa të rregulloj rrugën me ia ndal punimet kësaj kompanie.

**Kryetari i Komunës,** Ne nuk mundem me penguar kompaninë mos me punuar. Ne mundem me kërkuar se a e ka lejen, tonazhën të cilën po e përdorë, por jo me penguar. Me herët ka qenë një Vendim i Kryeministrit iç Republikës së Kosovës të cilin u ka dërguar kryetarëve të komunave, mos me i penguar punimet e kompanisë "Bektel Enka" në ndërtimin e punimeve të autostradës : Prishtinë - Shkup.

**z. Shemsedin Luzha,** Unë po shoh gropë në rrugë edhe këtu në qytet, por ka edhe rrugë të dëmtuara nga kompania " Bektel Enka", këto janë punë që shihen.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ne ë është gjendjen e rrugës për të cilën po flasim, se mua me bien me së shpeshti me kaluar atypari. Është e vërtetë së dëmtime të rrugës dhe shqetësimë të qytetarëve ka. Unë si Kryesues i Kuvendit kam dalë se bashku me qytetarët e asaj ane nja 3 herë dhe e kemi bllokuar rrugën dhe ka ardhur policia në mënyrë njerëzore na ka thënë me liruar rrugën, ndërkaq në fund të muajit korrik na kanë thënë se fillon me u bërë rehabilitimi i rrugës në fjalë. Është e vërtetë se rruga është në gjendje të rëndë, ku çdo ditë e më tepër po dëmtohen vetrat e qytetarëve që lëvizin aty pari, ndërkaq ka pasur edhe rreziqe me fatalitet, e sidomos në këtë periudhë kur është shtuar fluksi nga bashkatdhetarët e vendit. Ju nëse keni ndonjë zgjidhje, unë do iu përkrahi dhe do jam se bashku me ju. Ne kemi provuar të gjitha format, por gjendja është ende e pa ndryshuar. Ajo rrugë ka me u rregulluar, por deri sa të rregullohet ka me shkuar kohë. Ne jemi të shqetësuar të gjithë për këtë çështje. Nëse ka kush ndonjë zgjidhje lë të tregoj, po ne na është thënë se nuk kemi të drejtë ligjore me ndërrhyrë në punimet e kompanisë së "Bektel Enka". Ajo rrugë është magjistrale të cilën e menaxhon Ministria, ministria i ka dhënë leje, kështu nuk kemi çka me bërë. Ne kemi pasur kërkësë nga policia që, nëse nuk e lirojmë rrugën, do na largojnë me forcë.

**z. Bekim Koxha,** Po të ishë unë Kryetar i Komunës do të kisha bërë zgjidhjen e problemit të dëmtimeve të rrugëve nga kompania " Bektel Enka".

**z. Shemsedin Luzha,** Lidhur me dëmtimet e rrugëve në komunën tonë nga kompania "Bektel Enka", zgjidhje ka, sepse ne jemi zot shtëpie këtu në komunën tonë, sepse në këtë rast po dëmtohem i ne, po dëmtohen qytetarët e komunës tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Raporti e Punës së KKSBB e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 13 votë Për, 6 votë Kundër dhe 6 Abstenime. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për aprovimin e Raportit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi(KKSBB) për gjashtëmuajrin e parë të vitit 2018.

**3. Raporti gjashtëmuajor finançiar për periudhën: Janar-Qershor 2018:**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Fillimi isht ia jepim fjalën drejtorit të Financave, Bahri Selimi, pastaj e hapi diskutimin, ndërkaq kërkoj të respektohet, Rregullorja e Punës së Kuvendit për debate e replika.

**z. Bahri Selimi,** Raporti Financiar është i dhënë në formë detaje, kështu nuk do ta zgjasë shumë. Raporti ka për qëllim rritjen e transparencës në njëren anë dhe në anën tjetër për me e pa ekzekutivi i komunës se qysh i ka realizuar politikat e sajë lidhur me ecurinë financiare të gjitha aktiviteteve përmes metodave të përeaktuara me ligj, rialokimi i mjeteve apo politikave. 39.62% është dinamika e shpenzimeve për këtë periudhë. Në raport me buxhetin

fillestar të aprovuar, 5.5 % janë mbetjet buxhetore në raport me vitin e kaluar. Për Paga dhe Mëditje janë shpenzuar 48.8%, pastaj e dyta prinë Programi: Mallra dhe Shërbimet, Shpenzimet Komunale, Subvencionet dhe Transferet kanë shënuar ngritje për afér 50%, 17.12% janë realizuar Investimet Kapitale, kjo për shkak së në këtë 6 mujor me shumë punohet në, iniciimin e procedurave, lidhjes se kontratave e më pak në implementimin e projekteve. Në tabela janë paraqitur mjetet e shpenzuara sipas sektorëve në kategoritë shpenzuese buxhetore. Në vazhdim drejtori i shpjegoj se cili sektorë ka arritur realizim me të madh të shpenzimeve të këtyre

programeve buxhetore: Shëndetësi, Arsim dhe Administratë. Tabelat janë dhënë edhe në formë analitike në secilin program shpenzues buxhetor. Ka qenë kërkesë e disa delegatëve lidhur me disa kode buxhetore se çka përmbyjnë disa kode buxhetore. Krahasimet janë bërë në programet e caktuara buxhetore të shpenzimeve në raport me vitin paraprak, si të Mallra dhe Shërbime, Investime Kapitale, Subvencione dhe Transfere dhe Shpenzimet Komunale. Në vazhdim drejtori i dha me shifra disa nga shpenzimet për Mallra dhe Shërbime i dha arsyet e ngritjes sepse anëtarët e KK kanë nevojë të pajisen melaptop për aktivitetin e punës së KK, i arsyetoj edhe shpenzimet tjera në këtë pozicion si rrugë lokale, shpenzimet e varrimit, ngritjet apo uljet që kanë shënuar duke i potencuar arsyet. Mirëmbajtja e veturave, shkollave, drekave zyrtare shënojnë ulje. Të HVK shënojnë ngritje të Tatimi në pronë, e që jemi në rrugë të mirë me arritur realizim %. Progres kanë shënuar lejet e ndërtimit, ndërkaq rënie kanë shënuar, të hyrat nga inspektorati, e që ky realizim është shqetësim edhe i ekzekutivit të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Para se me hapur diskutimin iu njoftoj se kjo është Informatë për shpenzimet buxhetore për 6 muaj. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Selim Reka,** Të inkasimi i të HVK, shihet se është arritur realizim 38%. DEFZH ka arritur të realizoj inkasim mbi 50%, por jo edhe sektorët tjerë. Disa drejtori kanë realizuar vetëm 20%, kjo të bënë me kuptuar për planifikim jo të mirë të buxhetit apo mos angazhim i duhur në realizim nga sektorët përkatës. Të Inspektorati, nga ka ngeje në realizim të HVK. Të shpenzimet, të programi; Investimet Kapitale, janë realizuar 17.11%, ndërkaq ka ngecje të Programi; Mallra dhe Shërbime me 28%, sektori i Shëndetësisë ka realizuar pak shpenzime në këtë program, ndërkaq nevojat janë të mëdha në këtë sektor.

Ngritje të shpenzimeve nga raporti shihet se kemi në pozicionin: Mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve zyrtare. Të Kodit me Nr. 13403, shihet se është një gabim teknik. Të realizimi i objekteve. Renovimi i sallës së kuvendit, janë shpenzuar mbi 7.000€, ndërkaq nuk ka ndonjë renovim në sallë. Tjetër; Ka shumë mjete të alokuara, ndërkaq të paspenzuara. Realizimi për Investimeve Kapitale është i vogël. Nisur nga kjo, kërkojmë të ngriten kapacitetet dhe cilësia në këtë program buxhetor për gjatë periudhës vijuese.

**z. Ekrem Kęçku,** Nga Raporti financiar shihet se janë shpenzuar 17.11% e mjeteve buxhetore të Investimet Kapitale. Kjo shifër është shumë e ulët, ndërkaq mbetet në periudhën vijuese të shihet se a po rriten këto shpenzime buxhetore. Të HVK nga inspektorati janë 0. gjithashtu 0 janë të hyrat nga resurset natyrore. Kur jemi të inspektorati, duhani pihet gati në çdo lokal, gjithashtu mbeturina ka kudo, ndërkaq nuk shqiptohen gjoba nga zyrtarët e inspektoratit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka në këtë pikë, kështu konstatoj se Kuvendi i Komunës, U Informua me Raporti Gjashtëmuajor Financiar për periudhën: Janar-Qershori 2018 / Lënda: 01 Nr. 05-400/01-23621/18.

4. Propozim Vendimi pér transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018:

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në këtë pikë fjalën ia dha drejtorit të DEF, Bahri Selimi.

**z. Bahri Selimi,** Sqaroj se në cilat programe shpenzuese buxhetore janë bërë ndryshimet dhe arsyet e ndryshimeve dhe orientimi i mjeteve të ridestinuara, paraqitur si në tabelat që janë pjesë përbërëse e lëndës pér ridestinim të mjeteve buxhetore.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk ka kush, atëherë, Propozim Vendim e shtroj në votim dhe i njëjtë u aprovua me 18 votë Për, Kundër ishin 2 (Shemsedin Luzha dhe Bekim Koxha), Abstenuan 6 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018 / Lënda: 01 Nr. 60/01-2435/18.

5. Propozim Vendimi Paraprak pér ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-10, tokë bujqësore e klasës së III-të, në Zonën Kadastrale Kaçanik i vjetër në pronësi të Xheladin Krasniqi;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Këto Propozim Vendime kanë qenë në rend pune edhe në mbledhjen paraprake të KK, por në mungesë të kompletimit të materialit janë hequr nga rendi i punës. Tani këto çështje e kanë marrë miratimin nga KPF. Drejtori i DUKMM është prezent në mbledhje, nëse ka nevojë pér sqarime të nevojshme na njofton. Tre Propozim Vendimet janë të një natyre. Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Bekim Koxha,** Kam një pyetje pér drejtorin e DUKMM, A ka në atë parcelë të ndërtuar ndonjë objekt?

**z. Ukshin |Qallaku.** Në atë pjesë përreth asaj parcele ka të ndërtuara objekte të banimit – shtëpi.

**z. Adnan Reka,** Propozim Vendimet nga pikat 5.6 dhe 7 -pér ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore janë në kundërshtim me paragrafin 10.2 të Ligjit pér Tokën Bujqësore 02/L-26 si dhe paragrafit 6.2 dhe 8.1 të UA 41/2006, që ju i referoheni: Të nisi 10.2. Çdo ndërrim i destinimi sipas paragrafit 3 të këtij nisi, mund të bëhet vetëm sipas ligjit dhe me vendim të organit kompetent komunal, pasi të jetë marrë Pëlgimi nga Ministria në projektin e rregullimit hapësinor. Të nisi 6.2 ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore të klasës 1 deri 4 do t'ë bëhet me vendimin e Kuvendit Komunal pas marrjes së pëlgimit nga Ministria. Të nisi 8.1 Nëse sipas nisi 6.2 të këtij Udhëzimi Administrativ vendimi merret nga Kuvendi Komunal me pëlgimin e Ministrisë, procedura e ndërrimit të destinimit do të kryhet sipas dispozitave të këtij nisi.

Mua më vjen keq që ky organ në vazhdimësi e ka keqpërdorur këtë Kuvend duke shtyrë që të marrë vendime të padrejta dhe në kundërshtim me ligjin.

**z. Ukshin Qallaku,** Nëse këto Propozim Vendime aprovohen nga Kuvendi i Komunës, të njëjtat dërgohen në MAPI., dhe ky organ e vlerëson ligjshmërinë e tyre.

**Kryesueses i Kuvendit,** Unë e di se këto çështje kanë shkuan në ministri ende pa marrë vendim ne si kuvend. Ky çështë vetëm një Pëlqim Paraprak që duhet ta jep KK.

**z. Adnan Reka,** Ne këtu nuk kemi asnjë Pëlqim i cili na tregon neve se kjo çështje ka kaluar përmes Ministrisë dhe ministria e ka dhënë Pëlqimin dhe ne mundemi me iu referuar atij Pëlqimi, sepse këtu po shkruan pas Pëlqimit të ministrisë merret vendimi nga KK.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Edhe në Propozim Vendim shënohet qartë se është ljalja për marrjen e një akti paraprak. Nëse Ky Propozim Vendim vlerësohet nga MAPL se nuk është në rregull, atëherë nuk kthehet për rishqyrtim por procedura ndalet aty. Çështje të kësaj natyre janë miratuar edhe me herët, vetëm dallimi është se Propozim Vendimet kanë ardhur nga DBPZHR, nuk e di arsyen pse janë bërë këto ndryshime.

**z. Ekrem Raka,** Ne si anëtarë të Kuvendit të Komunës kur e kemi marrë detyrën jemi betuar se do të zbatojmë ligjin, kështu është mirë me ia adresuar MAPL këto çështje para se me i miratuar ne si kuvend, në mënyrë që mos të bëjmë ndonjë shkelje ligjore.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ne gati në çdo mbledhje kemi marrë vendime të kësaj natyre dhe me pas qenë të kundërligjshme MAPL na i kishte kthyer prapa, sikur na u kryhen dy vendime për ndërhyrje në Planin zhvillimor komunal, ndërkaq në raste të tillë nuk na është kthyer ndonjë vendim i kësaj natyre që është në kundërshtim me ligjin. Ne i kemi shkresat e MAPL se vendimet kanë qenë në harmoni me ligjin, kështu në këtë drejtim, unë mendoj se nuk jemi duke bërë shkelje të ligjit.

**z. Bekim Koxha,** Unë mendoj se kur një drejtor deklarohet për një çështje se e ka ditur se është në kundërshtim me ligjin dhe atë çështje na e ka adresuar neve si KK, kujtoj se nuk ka seriozitet të atij drejtori.

**z. Ukshin Qallaku,** Ne kemi pasur inspektor të te gjitha niveleve dhe procedura ka qenë në rregull, ndërkaq të këto çështje procedura është pak me ndryshe, sepse pasi të merr miratimin e ministrisë këto çështje i adresohen përsëri kuvendit.

**z. Ekrem Kyçyku,** Unë e përkrahi mendimin e z. Ekrem Raka, që të konsultohet paraprakisht MAPL për këto çështje, pastaj në bazë të mendimit të këtij autoriteti vendosim ne si kuvend.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për mua janë të qarta çështja se kemi të bëjmë me marrjen e vendimit paraprak. Përgjigjen ua kisha dhënë shumë shpejt se kemi konfirmime të kësaj natyre të cilat MAPL na i ka konfirmuar të ligjshme, dhe të njëjtat i kam në kompjuterin tim, por nuk po e shoh edhe të arsyeshme me shkua me ua sjellë tani. Drejtori e theksoj se ky çështë vendim paraprak, dhe kjo çështje vjen edhe një herë në KK. Nëse ministria jep vlerësim negativ, atëherë lënda nuk na vjen më në KK. Unë kujtoj se nuk duhet të pengojmë palët me ndërtuar, kështu t'i japim mundësi me proceduar me procedura të mëtutjeshme. Për kategorinë 1 dhe 2 e shqyrton KK, ndërkaq atë të 3 dhe 4 e merr një vendim paraprakisht edhe KK pastaj shkon në ministri dhe pas vlerësimit të ministrisë, lënda vjen edhe një herë në KK për marrjen e vendimit përfundimtar. Drejtori është këtu prezent dhe mund të na i sqaron këto çështje. Mua me kanë ardhur lëndët në procedurë, e imja ka qenë me proceduar me to, ndërkaq se si vendosni ju ajo është çështje tjetër.

**z. Ukshin Qallaku,** Ne duhet me qenë tē kënaqur që qytetarët e komunës po bëjnë kërkesa pér ndërrimin e destinimit e nuk po ndërtojnë pa leje ndërtimi.

**z. Selim Reka,** Ne kemi marrë si KK me herët vendime të kësaj natyre, por pér me marrë vendim përfundimtar nuk na ka ardhur më lënda asnjëherë.

**z. Adnan Reka,** Ndërrimi i pérhershëm i destinimit të tokës bujqësore të klasës 1 deri 4 do tē bëhet me vendimin e Kuvendit Komunal pas marrjes së Pëlqimit nga Ministria, a ma zbërtheni këtë dispozitë tē përektuar.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Drejtori i DUKMM duhet me u përgjigjur në këtë rast se a ka marrë shkresë nga Ministria e Bujqësisë. Diskutime të tjera nuk ka, kështu këtë Propozim Vendim e shtroj në votim pér aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 14 votë Për, Kundër ishin 10 anëtarë, Abstenoj, Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM PARAPRAK**

Pér ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-10, tokë bujqësore e klasës së III-të, në Zonën Kadastrale Kaçanik i vjetër në pronësi të Xheladin Krasniqi.

**6.** Propozim Vendimi Paraprak pér ndërrimin e destinimit të tokës Bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-9, tokë Bujqësore-kullosë e klasës së III-të zona kadastrale Kaçanik i vjetër në pronësi të Xhevahir Krasniqi;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka, pér këtë pikë e hapi diskutimin: Pér diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim pér aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 13 votë Për, Kundër ishin 11 anëtarë, Abstenoj Ekrem Raka.

Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë.

#### **VENDIM PARAPRAK**

Pér ndërrimin e destinimit të tokës Bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-9, tokë Bujqësore-kullosë e klasës së III-të zona kadastrale Kaçanik i vjetër në pronësi të Xhevahir Krasniqi.

**7.** Propozim Vendimi Paraprak pér ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të parcelës kadastrale nr.0968-7, tokë bujqësore kullosë e klasës së III-të, zona kadastrale Kaçanik i Vjetër në pronësi të Abedin Krasniqi.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka, pér këtë pikë e hapi diskutimin: Pér diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim pér aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 13 votë Për, Kundër ishin 11 anëtarë, Abstenoj, Ekrem Raka.

Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë.

#### **VENDIM PARAPRAK**

Pér ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të parcelës kadastrale nr.0968-7, tokë bujqësore kullosë e klasës së III-të, zona kadastrale Kaçanik i Vjetër në pronësi të Abedin Krasniqi.

## 8. Raporti i përformancës së komunave për vitin 2017:

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin e keni marrë, është një informatë shumë e gjërë, por ne duhet të fokusohemi të pjesa e komunës tonë. Për sqarime të nevojshme fjalën ia jap drejtorit të DAP, Festim Neziraj, pastaj e hapim diskutimin.

**z. Festim Neziraj,** Thoksoj se Raporti i ka disa gabime teknike drejtshkrimore dhe disa gabime të tjera, si të komuna e Kaçanikut, është shënuar Kaçanikut me "q" të butë dhe të përqindja e përformanës duhet të jetë 61 %, sepse diku është shënuar 58.83%.

**Kryesuesi i Kuvendit,** I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçku,** Nga Raporti i përformanës shihet se Komuna e Kaçanikut ka një përformançë të mirë me mbi 60% e shërbimeve të realizuara, ndërkaq në anën tjetër dihet se menaxhimi i mbeturinave nuk është në nivelin e duhur. E ulët është përformanca e të çështja e kanalizimeve, pastaj të personat me aftësi të kufizuara etj. Me intereson të di, çka është marrë si parametër për me nxjerrë këtë rezultat. Ajo çka me ka pëlqyer, janë rekomandimet e dhëna në këtë raport të përformanës të cilat rekomandime shpresoj të përbushën në të ardhmen.

**z. Adnan Reka,** Ndonëse ka ende mjaftë punë për t'u bërë, unë kësaj radhe e përgëzoj ekzekutivin qe nga vendi i 35 ka kaluar në vendin e 18 dhe ka treguar një performancë relativisht të mirë në raport me disa Komuna tjera të Kosovës.

**z. Nexhat Loku,** Të çështja e kanalizimeve, menaxhimi i mbeturinave, jo vetëm komuna jonë, por gati të gjitha komunat e Republikës së Kosovës kanë përformançë të ulët në këtë segment.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kjo ishte për informimin tuaj, kështu që konstatoj se, **Kuvendi i Komunës u Informua me Raportin e përformanës së Komunës së Kaçanikut për vitin 2017.**

**9.** Kërkesa e shefit të GP të LVV- Ekrem Kyçku, për ndërtimin e një, Hyrje-Dalje (Kyçje – Ç’ Kyçje) në Autostradën “ Arbër Xhaferi” Segmenti: Kaçanik- Hani i Elezit dhe anasjelltas.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkesa ka ardhur nga subjekti i LVV, nuk është askush kundër kësaj kërkese, kështu e kemi proceduar në kuvend. Për këtë pikë fjalën ia jap z. Shpend Krusha.

**z. Shpend Krusha,** Arsyja e kësaj Kërkese është së largësia ku është caktuar kyçja dhe ç kyçja e Kaçanikut në Autostradën në relacionin: Kaçanik- Hani i Elezit është shumë larg në Fushë të Pajtimit, ndërkaq nevojat strategjike të qytetarëve janë të mëdha kështu ai segment nuk mund të shfrytëzohet nga qytetarët e Kaçanikut, sepse për me arritur deri atje duhet të kalojnë 12 km për kyçje-ç kyçje. Pos kësaj, kjo largësi e bënë me të vështirë zhvillimin e biznesit në aspektin ekonomik dhe strategjik të qytetarëve të komunës tonë, sepse për me shkuar në Han të Elezit përmes autostradës, duhet t'i kalosh 44 km, d.m.th. një shkuarje ardhje diku 90 km. Kjo e bllokon Komunën e Kaçanikut për shkak të largësisë së hyrje-daljes, kur dihet se edhe lidhjet familjare e biznesore Komuna e Kaçanikut i ka të shumta me Hanin e Elezit. Arsyje tjetër janë, çështjet emergjente. Nëse ndodhë një rast, atëherë si do të menaxhohet, kur dihet se me arritur deri të kyçja në autostradë duhet ‘ti

bëjmë 6 km. Këto janë padrejtësi të cilat na janë bërë komunës tonë, ashtu që kjo komunë po i bartë vetëm dëmet e jo edhe të mirat e këtij projekti. Prandaj ndërtimi i një hyrje dalje në autostradë në afërsi të Kaçanikut do të ndikoj pozitivisht në lehtësimin e nevojat e qytetarëve të komunës tonë. Ne kërkojmë nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës që t'i bëjë Kërkesë. Qeverisë së Republikës së Kosovës- Ministrisë së Infrastrukturës për lejimin e një kyçje-ç kyçje në autostradën "Arbër Xhaferi" në afërsi të Kaçanikut, ndërkëq për lokacionin duhet të merren ekspert që merren me studimin e fizibilitetit.

**z. Nexhat Loku,** Këtë çështje e kam ngritur edhe më herët, por nuk kemi çka me bërë, kështu ne gishtin duhet me ngritur nga ministria. Është absurde që të kalon autostrada nëpër një qytet dhe mos të ketë kyçje-ç kyçje në afërsi të tij, kjo nuk është në rregull. Unë pajtohem me Kërkesën e LVV, por në fund, ne duhet të dalim me një. Konkluzion, për ndërtimin e, një vendi për kyçje-ç kyçje në autostradë, në afërsi të qytetit të Kaçanikut. Ndërkëq për studimin e fizibilitetit të bëhet nga ekspertë të fushës së caktuar përvendin ku do të ndërtohet, por duhet pasur parasysh që lokacioni të jetë sa me afër qytetit.

**z. Selim Reka,** Edhe ne subjekti politik i LDK jemi për kërkesën, ndërkëq sa i përket vendit, duhet studiohet nga ekspert të fushës, mundësish në ndonjë lokacion ku nuk preken tokat e bukës.

**z. Bekim Koxha,** Edhe ne subjekti politik NISMA, e përkrahim Kërkesën për ndërtimin e një kyçje-ç kyçje në Autostradë, sepse është nevojë dhe domosdoshmëri e qytetarëve të komunës tonë.

**z. Ekrem Raka,** Edhe subjekti politik IQI.K, e përkrah Kërkesën për ndërtimin e një kyçje-ç kyçje në Autostradën "Arbër Xhaferi" në afërsi të qytetit të Kaçanikut.

**z. Shpend Krusha,** Kërkesën propozoj të hartojmë përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, ndërkëq përvendin ne është vështirë me përcaktuar, kështu iu mbetet të përcaktojnë ekspertëve të lëmit përkatës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Zgjidhje për lokacion ka, por më mirë ua lëmë ekspertëve këtë çështje për shqyrtimin e fizibilitetit. Ndërkëq ne e kryejmë punën tonë me këtë kërkesë. Kërkesën do e hartojmë menjëherë pas mbledhjes në Zyrën time me shefat e grupeve parlamentare. Kështu, në bazë të prononcimeve të subjekteve politike, lidhur me këtë çështje del konkluzioni që t'i bëhet:

### KËRKESË

Qeverisë së Republikës së Kosovës -Ministrisë së Infrastrukturës, për ndërtimin e një vendi për kyçje - ç kyçje në Autostradën "Arbër Xhaferi" në afërsi të qytetit të Kaçanikut.

Kërkesa u vendos të hartohet nga përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike dhe e njëjta përmes Zyrës së Kryetarit të Komunës t'iu dërgohet organeve relevante të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërkëq Lokacioni- vendi i kyçje - ç kyçje në Autostradë në afërsi të qytetit të Kaçanikut, mbeti të përcaktohet nga ekspertë të lëmit përkatëse.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 12:45 e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët (26) të cilët ishin prezent në mbledhje.

Procesmbajtës

Makjire Malsiu



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**nga Mbledhja e VIII (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2018, mbajtur me 31 Korrik 2018.**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili .....
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,